

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

13.03.2023  
Ora 09:33

***RENDI I DITËS***

**Projektakti "Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, datë 11.03.2023 të depozituar nga Partia Demokratike".**

**PJESËMARRJA :**

**KAS: Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**


**Stafi KQZ: Y. Merkaj, E. Mema, I. Osmanaj**

**Parti Politike: Partia Demokratike (L. Nuraj, F. Nuri)**

**Z. I. Rusmali:** Mirëmëngjesi të gjithëve! Çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.29, të depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetar zotin Sali Berisha dhe me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.158 datë 09.03.2023 dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur rregjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga kryetari zoti Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Verifikojmë paraprakisht prezencën, ankuesi ka përfaqësues?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Po i nderuar përfaqësuesit e Partisë Demokratike me autorizimin i lëshuar nga kryetari i saj i paraqitur pranë Komisionit Qendror i Zgjedhjeve me ankimin e bërë, Ledio Nuraj dhe Franci Nori.

**Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. I. Rusmali:** Në rregull! Nga ana e administratës është Sekretari i Përgjithshëm zoti Ylli Merkaj dhe ekipi i tij si zakonisht në mbledhjet e KAS. Për paraprakisht ndonjë kërkesë paraprake nga ana e subjektit?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Po i nderuar, kemi një kërkesë paraprake në lidhje me shqyrtimin e ankimit në të cilën i kemi bërë edhe me shkrim. Ku do të depozitohet një kërkesë për përjashtimin e një anëtari të KAS, pikërisht të zotit Ledio Braho. Të gjithë shtjellimin ne e kemi me shkrim në dy faqe i nderuar.

**Z. I. Rusmali:** Duhet të na e thoni motivin që e kërkon.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Në bazë të nenit 16 të rregullores për mënyrën e funksionimit të zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve si dhe nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Ne kemi sjellë këtë kërkesë për përjashtim pasi në gjykimin tonë dhe nga çfarë na rezulton zoti Braho është punon bashkërisht në ushtrimin e profesionit të avokatit me përfaqësuesin e palës tjetër ankuese zotin Indrit Sefa. Kjo e argumentuar edhe me provat përkatëse që ne i kemi bashkëlidhur kërkesës për përjashtimin e zotit Braho, të cilat janë marrë nga facebook dhe në formë elektronike nga facebook e të dy personave ku këtu argumentohet që kanë ndjekur një sërë gjyqesh bashkarisht ku duket një lidhje tej shoqërisë në një lidhje miqësore dhe për ne përbën një konflikt interesi në këtë gjykim të këtij anëtari të komisionit i nderuar. Dhe për të patur një gjykim sa më të drejtë të pa anëshëm, transparent në lidhje me ankimin që ne kemi bërë, do të kërkonim përjashtimin e këtij anëtari si në konflikt interesi me çështjen.

**Z. I. Rusmali:** Juve argumentoni se zoti Braho ka një anëshmëri në...?

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Po i nderuar do ketë një anëshmëri në gjykimin e kësaj çështje.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull! Mund të na e depozitoni atë kërkesën. Nga ana e kolëgëve ka ndonjë deklaratë që ti trajtojmë të gjitha bashkërisht, kur të tërhiqemi ka ndonjë deklaratë? Jo. Në qoftë se ka pyetje nga kolegët për këtë kërkesë.


**Z. K. Bele:** Ta shikonim njëherë atë material shkurtimisht para se të bënim ndonjë pyetje.

**Z. I. Rusmali:** Erdal na e sill pak kërkesën ta shohim....

**Z. K. Bele:** Që të mund të kuptojmë çfarë është natyra e ....

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Provat i nderuar janë marrë nga facebook në lidhje me statuse, në lidhje me foto ku zoti Braho thotë “që ndihem mirë që falë punës sonë u bë drejtësi për mjekun mos të përmëndim emrin, pranë komisionerit për mbrotjen nga diskriminimi”. Që duket që kanë pasur çështje gjyqësore të ndjekur bashkërisht, të cilën e kanë faturuar ndoshta edhe bashkërisht dhe kanë marrë edhe rezultatin të cilin edhe e kanë parashtruar. Kemi foto ku kanë dalë në ambiente të punës, në ambiente të zyrës, në ambiente private bashkërisht, kemi një sërë dokumentacionesh të tilla që edhe pushimet i kanë pas kaluar bashkë, dreka-darka familjare kështu që është e kotë të zgjatëm qoftë edhe për çështje etike është ti bëjmë publike përpara publikut. Ne po u’a vëmë në dispozicion i nderuar, urdhwro.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. I. Rusmali:** Një pyetje kam unë për ju. Teksa bën referencën ligjore për kërkesën tuaj, ju përcaktoni si shkak për kërkesën edhe faktin se ka një interes personal drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë me vendimarrjen në shqyrtim. Ku e shihni ju interesin e drejtëpërdrejtë ose jo të drejtëpërdrejtë?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Interesi i drejtëpërdrejtë duket në lidhjet miqësore dhe në konfliktin e interesit që ka. Pavarësisht kësaj në gjykimin tonë është në interesin e drejtëpërdrejtë pasi ...


**Z. I. Rusmali:** Të lutem çfarë fiton zoti Braho nga vendimi? Nuk na duhet raporti miqësor, çfarë fiton zoti Braho nga pranimi ose nga rrëzimi i vendimit.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Qoftë që gjendet në konflikt interesi asaj ne nuk i kemi hyrë sepse ajo do një hetim më të thelluar i nderuar dhe mund ta vlerësoni ju atë, se çka fiton. Por zotëria ka qenë edhe kandidatë ...

**Z. I. Rusmali:** Ju keni përmendur dy shkaqe njëërën që ka indikacione për një anshmëri dhe ne do ta analizojmë, tjetrin interes të drejtëpërdrejtë. Kjo më bëri përshtypje prandaj e bëra.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Interesi i drejtëpërdrejtë lidhet edhe me vetë faktin që zotëria ka qenë kandidat i këtij grupimi për Avokat të Popullit ashtu siç jemi njohur edhe publikisht. Që do të thotë është në një marrëdhënie me personat me këtë grup të cilin ne ...

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. I. Rusmali:** Kandidat kam qenë unë, pse nuk kërkonti përjashtimin tim, edhe unë i këtij grupimi kam qenë?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Kjo ishte plotësuese.

**Z. I. Rusmali:** Kolegët pyetje?

**Z. K. Bele:** Unë shoh aty nga provat e sjella shoh pa i hyrë në detaj se mund të dojë kohë, por shoh që kanë datë, janë postime siç e kuptojë unë drejtë nga faqja e Indrit Sefës për të kuptuar marrëdhënien e palëve . I fundit që shoh është data 22.12.2022 pra ky është postimi i fundit me datë që provon marrëdhënien e tyre. Kemi ndonjë gjë që flet për ditët e fundit?

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Ato kemi mundur që të nxjerrim edhe ato kemi sjellë në lidhje me atë. Po nuk besoj se ka kaq shumë rëndësi data 22 Dhjetor apo data 22 Janar. Në qoftë se pastaj zotëria mund të paraqesë argumente që nuk ka marrëdhënie me këtë dhe që mund ti ketë shkëputur këto marrëdhënie mund tui referohet juve dhe në lidhje me shqyrtimin që do bëni juve si komision.

**Z. K. Bele:** Pra, ju keni mundur të provoni vazhdimin e një marrëdhënie të afërt deri më 22 Dhjetor.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Ne kemi mundur të provojmë që ka një marrëdhënie të afërt prej shumë kohësh deri në 22 Dhjetor, e cila zgjat me vite dhe që kanë pasur edhe marrëdhënie miqësore, edhe marrëdhënie pune ,edhe marrëdhie interesash që nënkuptohet.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. I. Rusmali:** Në rregull, falemiderit! Pyetje tjetër nga kolegët? Do na falni pak ne duhet të marrim vendim për këtë kërkesë paraprake pastaj të vazhdojmë.

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së:** Po i nderuar jemi në pritje.

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Rifillon seanca**

**09:46**

**Z. I. Rusmali:** Mirë, atëherë shpallim vendimin e ndërmjetëm për kërkesën për përjashtimin e anëtarit të KAS –it, zotit Ledio Braho, nga shqyrtimi i çështjes së ankimit të Partisë Demokratike me kryetar zotin Sali Berisha. KAS-i, pasi shqyrtoi argumentet e kërkuesit dhe provat bashkëlidhur kërkesës vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës, me këtë argument, të cilin do ta merrni edhe me shkrim me vendimin përfundimtar, por më gojë e keni të shtjelluar në këtë formë. Kërkesa se anëtari ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen në shqyrtim, nuk është e mbështetur dhe nuk provohet me asnjë dokument. Vendimmarrja për subjektin nuk i sjell asnjë përfitim, të asnjë lloj natyre as materiale, as morale anëtarit, kështu që ky pretendim bie. Sa i përket, kërkesës për njëanshmëri, për shkak të raporteve personale me përfaqësuesin e subjektit PD, siç ka thënë Komisioneri, me kryetar Lulzim Bashën edhe kjo kërkesë, edhe ky argument duhet të bjerë, sepse rrethanat, që kërkohet përjashtimi, bëjnë fjalë vetëm për rrethanat e një marrëdhënie shoqërore, nuk ka marrëdhënie biznesi të përbashkët, nuk ka motive të tjera që mund të futeshin në kuadrin e pengesave për njëanshmëri. Fakti që ka njohje dhe marrëdhënie shoqërore, qoftë edhe të ngushta, me përfaqësuesin e një subjekti tjetër, i cili nuk është prezent në këtë gjykim, nuk është as palë e interesuar, do të thotë edhe subjekti tjetër nuk e konsideron veten të interesuar për këtë çështje, nuk mund të qëndrojë, si argument, për të dalë në përfundimin që shoku i shokut është i interesuar në favor të subjektit tjetër, kur vetë subjekti nuk është i interesuar. Kështu që pak a shumë janë argumentet, që do t'i merrni të shtjelluara në vendim, për rrëzimin e kësaj kërkesë. Tani kalojmë te rendi i ditës: te shqyrtimi paraprak i kërkesës. Shqyrtimi paraprak kërkon që KAS-i të

7

**Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa**



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023***

marrë në shqyrtim dhe të shprehet lidhur me anën formale të kërkesës, me kontrollin dhe verifikimin e afatit ligjor brenda të cilit është bërë kërkesa, me kontrollin dhe verifikimin e legjitimitetit procedural të ankuesit, kontrollin dhe verifikimin e kompetencës së KAS-it për ta marrë në shqyrtim kërkesën ankimore. Ju, si kërkues, keni ndonjë gjë për të thënë për këtë element procedural?

**Z. L. Nuraj:** Po, i nderuar, në gjykimin tonë është që, kërkesa ankimore, e bërë nga ne, i plotëson të tria këto elemente procedurale në lidhje me kërkesat procedurale për ankimin pranë KAS-it, të shprehura në Kodin Zgjedhor, si dhe në rregulloren e KAS-it, faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! KQZ-ja ka ndonjë gjë për të thënë për këtë?

**Z. Y. Merhaj:** Po. Pas verifikimit të elementeve formale të kërkesës, mendojmë që kërkesa e elementit të tretë legjitimor të ankuesit nuk plotësohet, pasi nuk ka legjitimin për plotësimin e ankimit.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Faleminderit! Mirë, pyetje nga kolegët?

**Z. E. Çefa:** Për KQZ-në, vendimi objekt i këtij ankimi, i cili është edhe objekti i një ankimi tjetër pastaj, me nr. 31 kërkesë ankimore, është vendim që është shprehur definitivisht për rrëzimin e kërkesës së Partisë Demokratike, me kryetar zotin Sali Berisha, apo ju e konsideroni, ose Komisioneri e ka konsideruar vendimet ndërmjetëm dhe çështja e themelit do të trajtohet në një moment të dytë, proceduralisht flas gjithmonë.

**Z. Y. Merhaj:** Mendoj se vendimi i Komisionierit është bazuar në nenin 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 67 të Kodit të Procedurave



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023***

Administrative, i cili është vendim i ndërmjetëm dhe i plotëson të gjitha: është i arsyetuar, është dhënë me afat kohor, i ndërmjetëm.

**Z. I. Rusmali:** Vetë ankuesi si e konsideron vendimin që kundërshton?

**Z. L. Nuraj:** Atëherë, vendimi që kundërshton është në mënyrë të padrejtë kundër nesh.

**Z. I. Rusmali:** Ju lutem, se mbase nuk u shpreha unë qartë, e konsideroni vendim të ndërmjetëm, apo përfundimtar?

**Z. L. Nuraj:** Ne e konsiderojmë përfundimtar, pasi edhe në faqen e KQZ-së, që është shpallur vendimi, i nderuar, që mundësisht do të doja ta citoja, edhe në vendimin që ne kemi, është refuzimi i kërkesës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor i Partisë Demokratike të Shqipërisë, të depozituar nga kryetari i partisë, zoti Sali Berisha. Kështu që ne e konsiderojmë si një vendim përfundimtar. Ndërsa, në lidhje me kërkesën, e pjesës tjetër, pavarësisht se çështjet i bashkoi, ka qenë një vendim i ndërmjetëm, ku i kishte lënë 48 orë për plotësimin e dokumentacionit. Kështu që në këtë kuadër ne jemi i drejtuar me ankim KAS-it, si një ankim përfundimtar të Komisionierit.

**Z. I. Rusmali:** Domethënë, lidhur me kërkesën tuaj, ju nuk prisni vendim tjetër, ju konsideroni këtë që i ka mbyllur rrugën shqyrtimit të kërkesës suaj.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. L. Nuraj:** Duke u nisur në bazë të vendimit të Komisionierit dhe të dispozitivit, që na është vënë në dispozicion, që është marrë si një vendim përfundimtar. Ndërkohë ne në kërkesën tonë e kemi trajtuar...

**Z. I. Rusmali:** Cili dispozitiv ju është vënë në dispozicion juve?

**Z. L. Nuraj:** Vendimi nr.158 datë 9.3.2023 i Komisionierit.

**Z. I. Rusmali:** Po ky vendim në dispozitiv kërkon vetëm (po e quaj) nga pala tjetër që të plotësojë dokumentet për mangësitë që janë konstatuar. Kaq, nuk shprehet për ju.

**Z. L. Nuraj:** Ai na gjykoi bashkë si një, domethënë ai i bashkoi të dyja çështjet.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, të dyja çështjet janë të bashkuara, po dispozitivi i 158-s nuk flet...

**Z. L. Nuraj:** Në seancë në fjalën e tij ai ka thënë: “Plotësimin e dokumentacionit brenda 48 orëve të Partisë Demokratike.”

**Z. I. Rusmali:** Në seancë, në fjalën e tij ka folur për rrëzimin e kërkesës suaj?

**Z. L. Nuraj:** Në fjalën e tij ka thënë këto, ndërsa në faqen e KQZ-së, që unë e kam në foto këtu, tek uebsajti zyrtar është thënë: “Në seancën e sotme publike shqyrtohen kërkesat e partive politike për regjistrimin si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj. Në përfundim të shqyrtimit të

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023**

kërkesave dhe të dokumentacionit shoqërues, KSHZ-ja vendosi, ndër të tjera, pikën 3, “Refuzimin e kërkesës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, thuhet te faqja zyrtare, të Partisë Demokratike të Shqipërisë, depozituar nga kryetari i partisë, zoti Sali Berisha”. Vendimin këtu nuk e disponoj për momentin.

**Z. I. Rusmali:** Praktikisht, ju kundërshtoni Drilonën sot, jo Celibashin.

**Z. L. Nuraj:** Jo, Celibashin, i nderuar, se ne i përmbahemi ankimit, që ju keni dorëzuar dhe ankimi thotë: “kundërshtimin e vendimit të Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.158, datë 9.3. ndryshimin e vendimit duke vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj”. Ky vendim ka dalë nga bashkimi i shqyrtimit të çështjes...

**Z. I. Rusmali:** Të lutem, se ne duam të kuptojmë, ky është problemi. 158-n ne e kemi, çështja është se ju na referuat te njoftimi i shtypit, ndërkohë që neve nga duhet dispozitivi i vendimit, dhe dispozitivi i vendimit ka lidhje vetëm me palën tjetër dhe i kërkon asaj pale që të plotësojë dokumentacionin. Kaq është dispozitivi i vendimit. Në qoftë se mund të pyes sekretarin e Përgjithshëm: po përgatisni vendim përfundimtar për kërkesën e subjektit?

**Z. Y. Merkaj:** Jo, ende.

**Z. I. Rusmali:** Nuk e keni në plan, në agjendë?

**Z.Y. Merkaj:** Sipas eksperiencës së KQZ-së e kemi.

**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023**

**Z. L. Nuraj:** Kemi ecur me këtë vendim, i nderuar, duke qenë se edhe çështja u shqyrtua në të njëjtën datë, në të njëjtën orë, ishte e bashkuar dhe doli një vendim për të dyja çështjet, prandaj kemi ecur me ankimin e këtij vendimi.

**Z. I. Rusmali:** E kuptuam. A ka pyetje tjetër nga kolegët?

**Z. E Çefa:** Zoti Nuraj, për të sqaruar, mos ndoshta ju i jeni referuar pjesës arsyetuese të vendimit me objekt ankim të Komisionerit, i cili në një paragraf ose rresht thotë që pala, që ju përfaqësoni, nuk legjitimohet në regjistrimin e partisë dhe ndoshta kjo situatë, pak e paqartë në vendim, ju ka shtyrë ju të mendoni se ky do të jetë edhe vendimi përfundimtar ndoshta, por me të drejtë keni shfrytëzuar pastaj edhe të drejtën e ankimit ndaj çdo vendimi të Komisionerit.

**Z. L. Nuraj:** Po, edhe kjo ka qenë.

**Z. E. Çefa:** Faleminderit!

**Z. I. Rusmali:** Pyetje tjetër? Besoj pretendimet janë të qarta, ju kërkoni që ne ta pranojmë dhe ta kalojmë për shqyrtim këtë kërkesë ankimore, apo jo?

**Z. L. Nuraj:** Po.

**Z. I. Rusmali:** Dhe KQZ-ja kërkon që kjo të rrëzohet për mungesë legjitimiteti.

Mirë, do të na falni?

**Z. L. Nuraj:** Në gjykimin tonë nuk është mungesë legjitimiteti.

**Z. I. Rusmali:** A keni gjë për të thënë? A doni ta inspironi?

**Z. L. Nuraj:** Në gjykimin tonë, kjo kërkesë e KQZ-së nuk qëndron pasi, për sa ne jemi marrë në ankim, për sa ka dalë edhe një vendim për ne, ne automatikisht

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

legjitimohemi pasi kemi sjellë edhe dokumentacionin dhe jemi palë në këtë proces. Megjithatë kjo është në gjykimin tuaj.

**Z. I. Rusmali:** Meqë e hapëm, tani dispozitivi i vendimit i kërkon palës tjetër, vetëm palës tjetër që të plotësojë dokumente dhe asgjë tjetër. Pra, ky është urdhërimi i Komisionerit. Interesi i ligjshëm i juaji në raport me këtë urdhërim ku qëndron? Të mos plotësojë pala tjetër dokumentacionin?

**Z. L. Nuraj:** Ne kemi ardhur këtu sepse Komisioneri pavarësisht se dëgjoji dy palë, Komisioneri është shprehur për Partinë Demokratike të Shqipërisë. Dhe në gjykimin tonë Partia Demokratike e Shqipërisë ka qenë e përfaqësuar nga ne, duke pasur dhe dokumentacionin që ne i kemi dorëzuar, dhe për sa ne hymë në shqyrtim, për sa u mor dokumentacioni, u verifikua dokumentacioni dhe për sa u trajtua, si dy përfaqësues të një partie në strukturën e atij takimi, që u bë atë ditë, kështu që ne e kemi sjellë, si përfaqësues të Partisë Demokratike, i nderuar, në të dyja rrafshet.

**Z. I. Rusmali:** Dakord. Atëherë nuk ka gjë tjetër.

**Z. L. Nuraj:** Dokumentacioni i dorëzuar nga ne në gjykimin tonë nuk ka pasur nevojë për plotësime. Pra, në të dyja rrafshet ka ardhur kjo ankesë.

**Z. I. Rusmali:** Mirë nuk ka gjë tjetër për të shtuar. Kërkesat tuaja janë të qarta, edhe pozicioni i KQZ-së është i qartë, ne mund të mblidhemi me njëri-tjetrin dhe ta diskutojmë këtë gjë. Do të na falni 5 minuta, maksimumi 10 minuta, sa ta zgjidhim.

Tani do të keni durim, sepse do të bëjmë një arsyetim rreth logjikës, që kemi përdorur ne, sepse besojmë se ka rëndësi edhe për vazhdimin e punës, dhe pastaj do të lexoj dispozitivin. Tërhiqemi për vendimmarrje.


***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023***

*(Rifillon mbledhja, ora 10:11)*

**Z. I. Rusmali:** Siç e thamë, ne duhet të shqyrtonim kompetencën, legjitimitetin dhe respektimin e afateve. Ne konstatojmë që kërkesa ankimore është paraqitur në afat. Konstatojmë se vendimi i Komisionierit, për nga natyra e tij, është një vendim i ndërmjetëm, sepse ai nuk ia dhënë zgjidhje në themel as kërkesës suaj, pra kërkesës me numër protokolli 1329 datë 5.03.2023, dhe as kërkesës me numër protokolli 1337, datë 06.03.2023, të cilat i ka bashkuar në shqyrtim, siç jeni ju në dijeni. Komisioneri e ka të detyrim ligjor të shprehet me vendim për pranimin ose rrëzimin për secilën nga këto dy kërkesa. KAS-i është instanca e ankimit administrativ, dhe jo instancë e shqyrtimit fillestar të kërkesave. Ne nuk mund të ushtrojmë kompetenca, të cilat nuk na njihen shprehimisht nga ligji. Kjo do të thotë se KAS-i nuk mund të shprehet për themelin, siç ia kërkonti ju, pa u shprehur më parë Komisioneri si organ kompetent për shqyrtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave. Tjetër, vendimi i Komisionierit ka urdhëruar Partinë Demokratike me kryetar zotin Lulzim Basha, kështu thuhet në vendim, që të bëjë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim sipas porosive që ka dhënë Komisioneri. Te ky urdhërim i Komisionierit, Partia Demokratike me kryetar zotin Sali Berisha, nuk ka asnjë interes të ligjshëm. Nëse Partia Demokratike me kryetar zoti Lulzim Basha duhet të urdhërohet të plotësojë dokumentacionin ose jo, kjo është çështje që prek vetëm interesat e ligjshme të këtij subjekti. Partia Demokratike, me kryetar zotin Sali Berisha, ka interes të ligjshëm në vendimmarrjen e Komisionierit nëse ai vendos të regjistrojë si subjekt në zgjedhje Partinë Demokratike me kryetar zotin Lulzim Basha, nuk e ka marrë këtë vendim ende Komisioneri, ose, nëse ai vendos të rrëzojë kërkesën e Partisë Demokratike me kryetar zotin Sali Berisha për t'u regjistruar si subjekt në zgjedhje. As këtë vendim ai nuk e ka marrë. Sa kohë që nuk i ka marrë

14

***Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa***




***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023***

këto vendime, juve ju mungon legjitimiteti për ta vënë në lëvizje kundër këtij vendimi nr. 158 të KAS-in. Por KAS-i bën edhe një arsyetim më të gjatë se kaq, i cili, në fakt, është i rëndësishëm për subjektet por, në mënyrë të veçantë për administratën e KQZ-së. I kthehemi arsytimit: vendimi i Komisionerit është vendim i ndërmjetëm. Kodi Zgjedhor nuk përmban dispozita të veçanta për vendimet e ndërmjetme që ndërmerren nga organet e tij me një procedura administrative, por duke qenë se Komisioneri vepron gjatë shqyrtimit të kërkesave në cilësinë e përgjithshme të një organi publik në procedurë administrative, term i Kodit të Procedurave Administrative, për të vlejné dhe janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative që rregullojnë vendimet e ndërmjetme. Në nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se vendimet e ndërmjetme merren kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuar do të shkaktonte një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm në interesin publik apo të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve. Në gjykimin e Komisionerit, mosplotësimi i dokumentacionit shoqërues, të kërkesës nga ana e kërkuarit, Partia Demokratike me kryetar zotin Lulzim Basha, do të sillte mosregjistrimin e kërkuarit subjekt zgjedhor. E ka thënë Komisioneri këtë. Dhe ky është një dëm i rëndë në interesat e palëve. Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se vendimet e ndërmjetme bien nga fuqia kur mbaron afati i caktuar në to. Afati i caktuar për këtë vendim ishte 48 orë. Më tepër, po Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 130 të tij përcakton se për veprimet procedurale ku përfshihen edhe vendimet e ndërmjetme, mund të bëhet ankimi veçantë vetëm në rast se ligji parashikon të drejtën e ankimit të veçantë. Kodi Zgjedhor nuk ka asnjë parashikim për vendimet e ndërmjetme, për pasojë nuk ka as të drejtën për ankimim të veçantë, parashikimin e së drejtës për ankimim të veçantë. Prandaj, në respekt të dispozitave të mësipërme

15

***Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

të Kodit të Procedurave Administrative, KAS-i konstaton se vendimi numër 158, datë 11.03.2023, ka rënë nga fuqia në orën 10:00 të datës 11.03.2023 dhe pse përcaktimi i pikës 3 të dispozitivit të tij, pra kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve është i pavlefshëm. Ndaj vendimeve të ndërmjetme të Komisionerit nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë për shkak se kjo e drejtë nuk është përcaktuar shprehimisht nga Kodi Zgjedhor. Për të gjitha këto arsye KAS-i vendosi: Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 28, datë 11.03.2023, të paraqitur nga ankuesi Partia Demokratike me kryetar zotin Sali Berisha. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. Ky ishte vendimi që thamë ne. Shpresoj e thamë, ne vendosëm ta analizojmë plotësisht me ju, sepse ne e dimë që ju, publik, jeni shumë të interesuar për këto vendime, rëndësi ka që të kuptoni arsyetimin dhe të kuptoni që kjo është një masë procedurale që ne jemi të detyruar ta marrim, por kjo nuk do të thotë asgjë lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe pretendimeve që ju keni në raport me zgjedhjet. E mbyllim këtu seancën.

**Vendimi nr. 20**

*Zbardhi materialin audio  
Eneida Stefa*





**13.03.2023  
Ora 10:20**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 30 të subjektit "Lëvizja Bashkë".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y. Merkaj, E. Mema, I. Osmanaj
- **Parti Politike:** Partia Lëvizja Bashkë (A. Qori)

**Z. E. Çefa:** Mirëdita të gjithëve! Çelim seancën për verifikimin paraprak të kërkesës ankimore nr. 30, e paraqitur nga ankuesi "Lëvizja Bashkë", i përfaqësuar nga Arlind Qori, kundër vendimit nr. 157, dt. 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Relator i kësaj çështjeje, pas shortit të hedhur në KQZ, jam unë Elvis Çefa. Verifikojmë prezencën e palëve. Është prezent Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, që në këtë procedim përfaqëson Komisionerin. Është prezent edhe pala ankuese, Partia Lëvizja Bashkë, e përfaqësuar nga zoti Arlind Qori. Përpara se të fillojmë ndonjë deklaratë apo ndonjë kërkesë paraprake lidhur me trupin gjykues, në përbërjen e tij me ndonjë konflikt interesi të mundshëm të ndonjërin prej nesh, etj. Pra çështje të kësaj natyre keni? Jo, faleminderit! Nga kolegët? Nuk ka, atëherë mund të vazhdojmë. Shkurtimisht do ia jap fjalën Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së të na parashtroje faktet dhe rrethanat e çështjes dhe më pas fjalën do ta keni ju zoti Qori. Shkurtimisht vetëm për procedurë, kjo nuk është seanca e

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

themelit të çështjes. Sot do të marrim vendim nëse do ta shqyrtojmë në themel çështjen tuaj apo jo. Zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Po faleminderit! Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 158, dt. 09.03.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën e partisë politike “Lëvizja Bashkë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 14 Maj 2023. Pas shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar zotin Arlind Qori, me shkronjat listore bashkë në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 Maj. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim partia politike “Lëvizja Bashkë”, brenda afatit kohor dhe nga verifikimi i kërkesës ankimore nga shqyrtimi paraprak i elementëve formal, konstatohet se i plotëson të tre elementët. Kompetencë e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit e ka KAS-i që vendos për vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Legjërimi i ankusit është kryetari i partisë i cili ka interesa për regjistrimin e kësaj partie si dhe është respektuar afati kohor i parashikuar nga vendimi i Komisionerit. Faleminderit!

**Z. E. Çefa:** Faleminderit zoti Merkaj! Pra, sipas Sekretarit të Përgjithshëm kërkesa i plotësoj formalisht të gjithë elementet për tu trajtuar në seancë themeli nga KAS. Keni gjë për të thënë?

**Z. A. Qori, kryetar i Partisë Lëvizja Bashkë:** Edhe ne kërkojmë të njëjtën gjë. Kërkesa është bërë në afat, brenda 48 orësh.

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. E. Çefa:** Dakord, ju faleminderit! Atëherë Kas do të tërhiqet për vendim. Pyetje? Po, vazhdoni zoti Braho.

**Z. L. Braho:** Jo, do të doja nga Sekretari i Përgjithshëm që të na vëjë në dispozicion edhe gjithë dosjen me të cilën ka shqyrtuar hetimin administrativ, kërkesën e Komisionerit. Këtu kemi vetëm ankmin.

**Z. Y. Merkaj:** Patjetër jua sjell tani.

**Z. E. Çefa:** Pyetje të tjera nga Kolegët? Nuk ka, atëherë ne do të marrim 5 minuta kohë dhe do ju komunikojmë më pas vendimin, faleminderit.

Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin e kërkesës ankimore me nr. 30, me subjekt ankues subjektin “Lëvizja Bashkë”. Seanca e themelit do të zhvillohet nesër, në orën 9, këtu në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, seancën e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 21**

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

13.03.2023  
Ora 10.28

**RENDI I DITËS**

**Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 31, datë 11.03.2023 të  
depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,  
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Z. E. Mema.
- **Të tjerë:** Partia Demokratike (Rezart Kthupi)

**Z. K. Bele:** Çelim sot seancën publike të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar plotësimin e elementeve të formës e të përmbajtjes së kërkesës ankimore nr. 31 të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 158, datë 9.3.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjekt zgjedhor Partinë Demokratike sipas kërkesës nr. 27, datë 5.3.2023 dhe dokumentacionit shoqërues të saj. Sipas shortit të hedhur, bazuar në procedurën, neni 129 i Kodit Zgjedhor, relator i kësaj kërkesë jam unë, Koli Bele. E pranishme është trupa e KAS-it, 5 anëtarët, si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe administrata mbështetëse. Në këtë fazë palë tjetër e pranishme... Ju lutem identifikohuni.

**Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. R. Kthupi:** Partia Demokratike, zoti Enkelejd Alibeaj, përfaqësuar me prokurë nga zoti Rezart Kthupi, sipas prokurës nr. 998 repertori, 506 koleksioni, datë 13.3.2023.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Ka ndonjë kërkesë në këtë fazë të procedimit nga ana juaj lidhur me përbërjen apo ndonjë gjë tjetër? Ok. Duhet të kemi parasysh që kjo seancë ka të bëjë vetëm me elementet formale të ankimit, që kanë të bëjnë me kalimin ose jo për shqyrtim të kësaj çështjeje, jo me shqyrtimin e themelit të çështjes. Ia japim fjalën Sekretarit të Përgjithshëm shkurtimisht të shprehet lidhur me këtë kërkesë.

**Z. Y. Merkaç:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 158, datë 9.3.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor të këtij subjekti në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrim të subjektit zgjedhor Partia Demokratike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore datë 14 maj 2023, sipas arsytimit të këtij vendimi. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Partia Demokratike, e përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj brenda afatit të parashikuar, 48 orë, por në datën 11.3.2023 ka dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një shkresë me numër protokolli 1602, ku pretendon se dokumentacioni është i plotë i dorëzuar në dosjen e datës 9 mars 2023, nuk ka dokumentacion tjetër shtesë për të sjellë dhe kërkon shfuqizimin kryesisht të vendimit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. K. Bele:** Pra, sot Ylli, për ta kuptuar ne që flasim në këtë moment derisa jemi mbledhur në këtë seancë nuk ka një vendim të Komisionerit përfundimtar për këtë çështje.

**Z. Y. Merkaç:** Nuk ka një vendim përfundimtar. Ishim në pritje të plotësimit të dokumentacionit të kthyer. Ende nuk është kthyer sot.

**Z. K. Bele:** Është analizuar nga ana juaj, në dijeninë tuaj, nëse në përfundim të këtij afati 48 orësh do të duhet të bëhej një seancë, të çmohej mosjellja e dokumentacionit apo eventualisht të dilej me një vendim, apo jo. Pra, ka një procedurë administrative?

**Z. Y. Merkaç:** Në eksperiencën e KQZ-së kthehet dokumentacioni për plotësim. Në qoftë se partia politike, subjekti brenda afatit kohor të parashikuar nga vendimi i Komisionerit nuk kthehet, atëherë Komisioneri del me një vendim përfundimtar.

**Z. K. Bele:** Përfaqësuesi.

**Z. R. Kthupi:** Faleminderit! Përpos shkresës, e cila është adresuar për mosplotësimin e të metave, që ka qenë qëndrimi i Partisë Demokratike në lidhje me kërkesën e Komisionerit, nga ana e partisë është bërë edhe ankim, që do të thotë akti fillestar i Komisionerit, pavarësisht nëse Komisioneri do të vendosë që këtë akt ta konkludojë me një akt tjetër, është ankimuar. Në këto kushte, ankimi i aktit fillestar është e nevojshme që të shqyrtohet në rrugë administrative nga KAS-i, sepse është një ankim i depozituar në kohën e kërkuar nga ligji nga një akt administrativ në formën e kërkuar nga ligji, për pasojë nuk shmanget fakti nëse Komisioneri do të dalë me një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën që ka adresuar subjekti politik. Ne

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

gjykojmë që në kushtet aktuale dhe me dokumentacionin që është paraqitur, ankimi që është regjistruar duhet të merret në shqyrtim nga KAS-i dhe KAS-i do të shprehet me vendim në lidhje me këtë ankim. Nëse Komisioneri do të marrë vendim tjetër, është e drejta e Komisionerit, por kjo nuk e zhbën detyrimin e KAS-it për të marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur.

**Z. K. Bele:** Keni ndonjë pyetje?

**Z. I. Rusmali:** Vendimin nr. 158 unë e lexova disa herë, po, mbase e kam lexuar gabim. Nuk më rezulton që vendimi vetë të ketë vendosur afat 48 orë. Ju jeni të vetëdijshëm për afatin 48 orë? Ju është thënë me gojë, është në procesverbalin e seancës me Komisionerin? Si është përcaktuar afati 48 orë?

**Z. R. Kthupi:** Afati 48 orë është afat deklarativ gjatë kohës që Komisioneri arsyetonte vendimin në seancë dhe përpos afatit deklarativ në seancë, është fakt publik që Komisioneri ka mbajtur qëndrim mediatik në lidhje me ekzistencën e afatit 48 orë, afat i cili parashikohej në deklaratat publike të Komisionerit dhe përfundonte ditën e premte a të shtunë në orën 24.00. Përpos faktit që nuk është në vendim, është një akt deklarativ i bërë në seancë, përpos seancës, ka edhe një deklaratë publike të Komisionerit për zgjatjen e këtij afati deri në përfundim të orës 24.00.

**Z. I. Rusmali:** Për Sekretarin e Përgjithshëm, dispozitat për afatet përcaktojnë që për të gjitha aktet e llogaritura me orë, afati fillon në orën vijuese, për ato që janë me ditë, në ditën vijuese. Në qoftë se zbatojmë këtë rregull, praktikisht i binte që afati

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

48 orë të mbaronte në orën 10 të ditës së shtunë, jo në orën 24.00 të ditës shtunë.  
Nga na del ora 24.00 e ditës së shtunë?

**Z. Y. Merkaj:** Në fakt, ashtu është, ora 10 ishte mbarimi i afatit 48 orë i caktuar nga Kodi Zgjedhor dhe nga Komisioneri për plotësimin e dokumentacionit, por duke qenë se favorizuar dhe jemi duke favorizuar partitë jo vetëm në këtë rast, por edhe në depozitimin e dokumentacionit, edhe në depozitimin e listave shumemërore që, sipas llogaritjeve të Kodit Zgjedhor, i bie data 26 mars, ne e kemi shtyrë më 27 mars thjesht për t'i lënë kohë.

**Z. I. Rusmali:** Ky favorizim që i bëni opozitës, nuk keni frikë që prish barazinë në zgjedhje? Se gjithmonë favorizime opozitës ju. Ç'është kjo punë?

**Z. Y. Merkaj:** Janë të gjitha subjektet.

**Z. I. Rusmali:** E keni me të gjitha. Ok.

**Z. K. Bele:** Afati është 17 mars?

**Z. I. Rusmali:** Afati ishte nga 9 në 11. Në datën 11 në orën 10.00 mbaronte afati.

**Z. Y. Merkaj:** Bëra një paralelizëm për të treguar që ...

**Z. I. Rusmali:** Për sa kohë i favorizoni të gjithë, jeni në rregull.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. K. Bele:** Kësaj shkrese që ka sjellë përfaqësuesi në KQZ i është kthyer ndonjë përgjigje, apo do të kthehet përgjigje me vendimmarrje?

**Z. Y. Merkaj:** Kjo do të jetë pjesë e dosjes që do të marrë vendim përfundimtar.

**Z. K. Bele:** Ka ndonjë rend dite për këtë vendimin?

**Z. Y. Merkaj:** Ndoshta nesër mund të merret vendimi.

**Z. F. Nuri:** Përshëndetje edhe një herë! Ne kemi depozituar një kërkesë për marrjen pjesë si palë e interesuar në këtë shqyrtim.

**Z. I. Rusmali:** Kur e keni depozituar kërkesën?

**Z. F. Nuri:** E kemi depozituar në orën 9.20 në protokoll.

**Z. K. Bele:** Ka ardhur kjo kërkesë?

**Z. Y. Merkaj:** Kërkesa shkon nga protokolli te kryetari. Nga kryetari vjen tek mua. Gjatë kësaj kohe unë kam qenë në seancë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord.

**Z. K. Bele:** Dorëzoje, Franci! Parimi është që vihet para çeljes së seancës, se seanca ka pasur një orar publik të përcaktuar. Ne bëmë vrapin e nevojshëm për ta arritur.

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. F. Nuri:** Ju kërkojmë ndjesë.

**Z. K. Bele:** Në praktikën e KAS-it ka qenë që të mos tregohemi rixhidë me interesin e palëve, kështu që ju bëheni pjesë e këtij shqyrtimi. Është relatuar në këtë fazë qëndrimi i palëve. Nuk e di nëse keni ndonjë ndërhyrje për të bërë përveç të qenit prezent.

**Z. F. Nuri:** Ne të njëjtën ndërhyrje do të bënim që bëme edhe më parë, kërkesën për përjashtimin e anëtarit, zoti Ledio Braho. Meqenëse jemi si palë e interesuar...

**Z. I. Rusmali:** Më fal, në qoftë se ndërhyj. Kompromisi e kërkon që ti erdhe me vonesë, do ta harrosh këtë kërkesë, sepse momenti i kërkesave paraprake ka mbaruar. Ne jemi në shqyrtim të çështjes. Kështu që mos na kthe mbrapsht. Na thuaj çfarë qëndrimi ke për çështjet e anës formale.

**Z. F. Nuri:** Atëherë për çështje të anës formale ju kuptova drejt, ne gjykojmë që edhe pala prezente nuk duhet të legjitimohet njësoj si ne.

**Z. I. Rusmali:** Për çfarë arsye?

**Z. F. Nuri:** Për arsye sepse edhe ata nuk i kanë të gjitha dokumentet në rregull. I mungojnë një sërë dokumentesh, autorizimi e me radhë.

**Z. I. Rusmali:** Nuk legjitimohen, pse? Nuk kanë të drejtë të ligjshme në raport me këtë vendim?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

**Z. F. Nuri:** Jo, ata kanë të drejtë të ligjshme për t'u ankuar në raport me këtë vendim, por e kisha më tepër me thelbin, i nderuar.

**Z. I. Rusmali:** Për kompetencën e KAS-it ke...

**Z. F. Nuri:** Patjetër që KAS-i është kompetent, patjetër. Nuk kemi çfarë të themi këtu.

**Z. K. Bele:** Ka pyetje të tjera nga kolegët në këtë fazë? Atëherë KAS tërhiqet për vendim dhe do t'ju njoftojmë në një afat sa më të shkurtër të mundshëm që ndoshta është 10 minuta. Gjithsesi, rrini afër.

***Rifillon***

***Ora 10.56***

**Z. K. Bele:** Vendimin po e japim me një arsyetim të përmbledhur, i cili do të zbardhet më vonë, ku shpjegojmë qëndrimin që po mban KAS-i dhe në fund do të japim edhe dispozitivin. Pra, ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij për shkak se vendimi i Komisionerit nr.158, datë 9.3.2023 prek drejtpërdrejt interesat e tij të ligjshme, konkretisht të drejtën për të kërkuar regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Vendimi i Komisionerit objekt ankimi për nga natyra e tij është vendim i ndërmjetëm, ai nuk i ka dhënë zgjidhje në themel kërkesës. Komisioneri ka detyrim ligjor të shprehet me vendim për pranimin ose rrëzimin e saj. KAS-i është instanca e ankimit administrativ dhe jo instancë e shqyrtimit fillestar të kërkesës. KAS-i nuk mund të ushtrojë kompetenca të cilat nuk janë njohur

***Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

shprehimisht nga ligji. Kjo do të thotë se ai nuk mund të shprehet për themelin e kërkesave pa u shprehur më parë Komisioneri si organ kompetent për shqyrtimin e tyre. Pra, KAS-i nuk ka kompetencë për urdhërimin për regjistrimin si subjekt zgjedhor të Partisë Demokratike të Shqipërisë si instancë fillestare, sikundër kërkohet nga ankuesit. Vendimi i Komisionerit objekt ankimi, është vendim i ndërmjetëm. Kodi Zgjedhor nuk përmban dispozita të veçanta për vendimet e ndërmjetme që merren nga organet e tij në procedurat administrative. Meqenëse Komisioneri vepron gjatë shqyrtimit të kërkesave në cilësinë e përgjithshme të një organi publik në procedurë administrative, për të vlejné dhe janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative që rregullojnë vendimet e ndërmjetme. Në respekt të këtyre dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, KAS-i konstaton se vendimi nr. 158 ka rënë nga fuqia e tij në orën 10.00 të datës 11.3.2023 dhe përcaktimi i pikës 3 dispozitive është i pavlefshëm. Ndaj vendimeve të ndërmjetme të Komisionerit nuk mund të ushtrohet ankim i veçantë për shkak se kjo drejtë nuk është përcaktuar shprehimisht në Kodin Zgjedhor. Këto vendime mund të ankimohen bashkë me vendimin përfundimtar të procedurës konkrete administrative. KAS-i nuk mund të pranojë kërkesën për shfuqizimin e vendimit, kur vendimi ka rënë dhe nuk mund ta detyrojë Komisionerin të regjistrojë subjektin zgjedhor sipas kërkesës dhe dokumentacionit përkatës paraqitur nga Partia Demokratike nga përfaqësuesi, zoti Indrit Sefa në një kohë siç doli edhe gjatë shqyrtimit të shprehur edhe nga përfaqësuesit e KQZ-së, Komisioneri është ende në një procedurë shqyrtimi dhe nuk ka dalë me vendim përfundimtar për kërkesën. KAS-i konstaton, dhe kjo është e rëndësishme të vihet në dijeni të palëve, përfshirë edhe administratën, që vendimi i Komisionerit për regjistrimin ose jo të kërkuesit nuk mund të merret përtej afatit të përcaktuar nga pika 1 e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, sepse përndryshe do të cenonte një të drejtë të rëndësishme të kërkuesit

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.13.03.2023*

në cilësinë e tij si subjekt zgjedhor, të drejtën për të formuar dhe për të marrë pjesë në koalicione. Rrëzimi i kërkesave të paraqitura në këtë kërkesë ankimore, për shkaqet e cituara nga lart, nuk prek të drejtën e kërkuarit për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar të Komisionerit lidhur me kërkesën nr.1337, datë 6.3.2023 në emër të Partisë Demokratike për regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për qeverisjen vendore. Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative, neni 128, kërkuari gëzon të drejtën e plotë që, nëse Komisioneri nuk del me vendim përfundimtar për kërkesën e sipërcituar, pra ai që do të ishte një mosveprim administrativ, të deponojë ankim në KAS ndaj Komisionerit në marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën. Për sa më sipër, vendosi mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nga ankuesi Partia Demokratike. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit brenda 5 ditësh nga shpallja e tij. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 22**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

